



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTER

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PER PERIUDHËN PRILL - QERSHOR 2024

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
06	10.05.2024	Lidhur me kapacitetet e emergjencave civile në bashkinë tonë 1.Sa është numri i stacioneve të MZSH në bashkinë tuaj? 2.Sa është numri total i makinave zjarrfikëse në bashkinë tuaj 3.Sa është numri i efektivëve të mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi(zjarrfikës dhe punonjës) 4. Cilit vit i përkasin automjetet zjarrfikëse dhe a mund të specifikoni nëse janë blerë nga fondet e bashkisë apo donacionet? 5. A ka Bashkia plane afatshkurtra për blerje mjetesh të reja apo	13.05.2024	1-Bashkia Mallakastër ka 1 (një) stacion zjarrfikës. 2-Sektori i MZSH-së Mallakastër ka 1 (një) automjet zjarrfikës , dhe 1 (një) automjet foristradë . 3- -Sektori i MZSH-së Mallakastër ka 12 (dymbëdhjetë) punonjës zjarrfikës. 4 - Automjeti zjarrfikës është Mercedes Benz viti 1995, automjeti Foristradë është Toyota Hilux viti 2010. Automjetet janë blerë me	Përfunduar elektronikisht	Pa pagesë

		investime lidhur me këtë program?		fondet e Bashkisë. 5 -Sektori i MZSH-së Mallakastër ka bërë kërkesë pranë bashkisë për pajisje me automjete të tjera .		
07	05.06.2024	<p>1. A ka patur bashkia buxhet të planifikuar për rininë për periudhën Janar-Dhjetor 2023</p> <p>2. Sa është numri total i punonjësve në bashkinë tuaj (2023) ? Sa janë femra e sa janë meshkuj? Po persona me aftësi të kufizuara ,edhe sipas gjinisë.</p> <p>3.Sa është numri i të rinjve (18-29)punonjës të bashkisë tuaj në vitin 2023?Sa femra ,sa meshkuj,sa me aftësi të kufizuara?</p> <p>4. Sa është numri i të rinjve (18-29)punonjës të bashkisë tuajtë cilët mbajnë pozicione drejtuese dhe vendimmarrëse? Sa femra,sa meshkuj ,sa me aftësi të kufizuara?</p> <p>5.A ka bashkia juaj politika rinore të zhvilluar specifikisht për grupmoshën 15-29 vjeç/</p> <p>6. A këni në institucionin tuaj drejtor,sektorë staf të dedikuar për rininë?</p> <p>7.A ka struktura rinore të ngritura në bashkinë tuaj dedikuar grupmoshës së të rinjve 15-29 vj për periudhën janar-dhjetor 2023</p> <p>8.Me kë keni bashkëpunur për ngritje e struktura të tilla.</p> <p>9.A ka një plan veprimi për këshillin vendor rinor . sa aktivitete janë</p>	14.06.2024	<p>Në respektim të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit ”,ju lutem gjeni si më poshtë përgjigjen e kërkesës:</p> <p>1.Bashkia jonë nuk ka patur buxhet vjetor të planifikuar për rininë(15-29)</p> <p>2.Numri total i punonjësve në bashki për 2023 është 411 punonjës;194 janë femra dhe 217 meshkuj.Person me aftësi të kufizuara është 1 mashkull.</p> <p>3.Numri i të rinjve të punësuar në bashki është 9 ;nga këta 7 femra dhe 2 meshkuj. Persona me aftësi të kufizuara nuk ka .</p> <p>4. Numri i të rinjve (18-29)të cilët mbajnë pozicione drejtuese dhe vendimmarrëse është 0 (zero)</p> <p>5 .Bashkia nuk ka politika rinore të zhvilluara specifikisht për grupmoshën 15-29 vjeç</p> <p>6. Në bashkinë tonë nuk ka drejtor apo sektor të dedikuar për rininë. Ka një koordinator për Rininë i cili koordinon dhe bashkërendon punën për</p>	Përfunduar elektronikisht	Pa pagesë

		<p>organizuar nga KVR përgjatë 2023?</p> <p>10.Sa të rinj janë përfshirë në KVR</p> <p>11.A keni pasur ju forma të tjera bashkëpunimi?</p> <p>12.Sa është me përafërsi pjesëmarrja e të rinjve në konsultimet publike të zhvilluara nga bashkia</p> <p>13.Lutemi listoni mjetet e komunikimit që përdor baaashkia juaj dhe link përkatës të faqes së uebit të bashkisë.</p> <p>14.Sa është numri total i përfituesve nga skema e ndihmës ekonomike</p> <p>15.Sa është nr. i të rinjve 15-29 vj përfitues për 2023</p> <p>16. Sa është numri total i përfituesve të pagesës së aftësisë së kufizuar për vitin 2023</p> <p>17. Sa është numri i të rinjve 15-29 vj përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar për 2023</p> <p>18.Sa është nr total personave të cilët janë pjesë e shërbimit të kujdesit shoqëror për vitin 2023</p> <p>19 Sa është nr i të rinjve 15-29 të cilët janë pjesë e shërbimeve të kujdesit shoqëror për vitin 2023</p>		<p>funksionimin e këtij Këshilli.</p> <p>7. Nuk kemi zyra ose qendër për rininë por nëse do të ketë projekte Bashkia Mallakastër do të marr përsipër pjesën takuese të financimit për ndërtimin dhe funksionimin e një qendre rinore</p>		
08	07.06.2024	<p>Në kuadër të mbrojtjes dhe të ruajtjes së integritetit ekologjik të brigjeve të lumenjve ,tokave lumore dhe shtretërve të zhavorrit pranë tyre kërkohet informacion:</p> <p>1.Lista e Digave, Barrierave dhe Pritave: Te na vihet ne dispozicion një liste e plote e te gjitha digave,</p>	19.06.2024	<p>1-Aktualisht ne basenin e lumit Vjosa ne siperfaqen qe pershkron ne Bashkine Mallakaster jane ndertuar barriera (panelet) qe permiresojne erozionin e tokave ne fshatin Hekal ,Njesia Administrative Hekal ,Bashkia Mallakaster per te</p>	Përfunduar elektronikisht	Pa pagesë

		<p>barrierave dhe pritave qe janë ne shfrytëzim, ne faze ndërtimi, te planifikuara ose nen shqyrtim ne basenet e lumit Vjose.</p> <p>2.Projektet e Ardhshme dhe Planifikimet: A jeni ne dijeni te planeve qe janë ne proces shqyrtimi apo zbatimi për ndërtimin e barrierave, pritave apo digave brenda pellgut ujëmbledhës te lumit Osum, po ashtu dhe ne degëzimet e tyre, deri ne vitin 2030?</p> <p>3.Dekomisionimi i Barrierave dhe Digave: A ka ndonjë plan, çështje ne shqyrtim, vendim apo proces dekomisionimi (heqje nga lista, heqje fizike) për barrierat, pritat apo digat qe janë aktualisht ne funksion te bujqësisë apo ne shërbim te funksioneve te tjera?</p>		<p>mbajtur nen kontroll rrjedhjen e ujit per mos grryerjen e tokave qe ndodhen afer lumit Vjose .Keto barriera jane ndertuar ne vitin 2020. Eshte kerkuar nga ana e Bashkise Mallakaster ne institucionet perkatese ndertimi i barrierave (panele)ne fshatin Çorrush, Njesia Administrative Kute ,Bashkia Mallakaster ne pjese ku kemi kostatuar se duhet te kryhet ndertimi i ketyre barrierave.</p> <p>2- Ne lidhje me projektet e planifikuara per nderhyrje ne digat qe ndodhen ne zonen qe perfshin baseni i lumit Vjose, ju informojme se eshte planifikuar per tu zbatuar brenda 1 viti rehabilitimi i Diges se rezervuarit te Gaduroves.</p> <p>3-Per sa i perket dekomisionimit te digave apo barrieave qe jane aktualisht ne funksion te bujqesise apo ne sherbim te funksioneve te tjera qe jane ne administrim te Bashkise Mallakaster nuk ka asnje plan apo ceshtje ne shqyrtim apo vendim per heqje nga lista te digave qe jane ne funksion te bujqesise apo funksioneve te tjera te cilat ndodhen ne territorin e</p>	
--	--	---	--	--	--

				Bashkine Mallakaster.		
09	24.06.2024	<p>1. Në ç'mënyrë bëhet grumbullimi, trajtimi dhe largimi i ujërave të ndotura që përdorin banorët në Njësitë Administrative Kutë dhe në Njësinë Administrative Hekal?</p> <p>2. Nëse në këto njësi (ose në fshatra të veçantë të tyre) ekziston shërbimi i grumbullimit dhe i trajtimit të ujërave të ndotura, cilat janë funksionet e tij; çfarë teknologjie përdoret për trajtimin e këtyre ujërave dhe çfarë përmban konkretisht procesi i trajtimit të ujërave të ndotura (mekanik, biologjik, kimik...)?</p> <p>3. Nëse teknologjia e mësipërme nuk ekziston, çfarë mënyre përdoret, në secilin prej fshatrave të këtyre njësive përt trajtimin e ujërave të zeza?</p>	03.07.2024	<p>Ne baze te ligjit 119/2014 "Per te Drejten e Informimit: Njesia U-K Mallakaster per Njesine Administrative Hekal nuk ka rrjete te K.U.Z -se kurse per Njesine Administrative Kute eshte nje pjese e abonenteve qe kane rrjete te K.U.Z , pasi keto investime jane bere ne kohen e ish-Komunave. Njesia Operacionale Ujesjelles Kanalizime Mallakaster nuk ka impiant te trajtimi te ketyre ujerave te KUZ.</p>	Përfunduar elektronikisht	Pa pagesë